



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL**

Adresa: Rr. "Abdi Toptani", ish-hotel "Drini", Tiranë

Tel: 04 2226814; 22268142

Nr. 423/3 Prot.

Tiranë, më 22.06.2017

**V E N D I M**

Nr.135, datë 22.06.2017

***"Mbi përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit nr. 10, datë 26.01.2016  
"Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në  
Bashkinë Shijak", të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil***

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, si dhe nenin 34 e vijues të Rregullores, "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit nr. 10, datë 26.01.2016 "Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në Bashkinë Shijak", të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil

**VËREJ SE:**

Me Vendimin nr.102, dt. 23.09.2015, "Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjit për administrimin e shërbimit civil, në njësinë e qeverisjes vendore, Bashkia Shijak ", është realizuar mbikëqyrja në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, pranë këtij institucioni.

Në Vendimin nr.10, datë 26.01.2016, "Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në Bashkinë Shijak", Komisioneri ka vendosur:

- 1.Të miratojë raportin përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil, në subjektin, Bashkia Shijak, i cili është pjesë e këtij vendimi.
- 2.Të kërkojë nga njësia përgjegjëse pranë Bashkisë Shijak, si struktura përgjegjëse për administrimin e burimeve njerëzore në këtë institucion, që të rregullojë pasojat lidhur me punonjësit të cilët nuk plotësojnë kriteret për të qenë nëpunës civilë, për shkak se nuk plotësojnë nivelin arsimor, si më poshtë:

- \*\*\*\*\* , në pozicionin e punës “Specialiste në Sektorin e Taksave dhe Tarifave Vendore”;
- \*\*\*\*\* , në pozicionin e punës “Specialiste në Sektorin e Infrastrukturës dhe Shërbimeve Publike”;
- \*\*\*\*\* , në pozicionin e punës “Specialiste e Taksave”;
- \*\*\*\*\* , në pozicionin e punës “Specialiste në Sektorin Urbanistik”;
- \*\*\*\*\* , në pozicionin e punës “Specialist Topograf”;
- \*\*\*\*\* , në pozicionin e punës “Inspektor Ndërtimi”;
- \*\*\*\*\* , në pozicionin e punës “Specialist i Planifikimit Kadastral”;
- \*\*\*\*\* , në pozicionin e punës “Inspektor Ndërtimi”;
- \*\*\*\*\* , në pozicionin e punës “Specialist Veteriner”;
- \*\*\*\*\* , në pozicionin e punës “Përgjegjës Sektori i Shërbimeve”;
- \*\*\*\*\* , në pozicionin e punës “Specialist i shërbimeve”;
- \*\*\*\*\* , në pozicionin e punës “Specialist i shërbimeve”;
- \*\*\*\*\* , në pozicionin e punës “Inspektor i Tatim Taksave”;
- \*\*\*\*\* , në pozicionin e punës “Arkivist”;
- \*\*\*\*\* , në pozicionin e punës “Inspektor Pyje dhe Kullota”.

Në këtë rast, njësia përgjegjëse duhet të rregullojë situatën, duke kryer veprimet sipas këtij rendi:

- Të nxjerrë aktin e refuzimit të statusit si nëpunës civil dhe të vendosë përfundimin e marrëdhënies së punësimit për këta punonjës, duke evidentuar faktin se, ata nuk i përmbushin kriteret për të qenë nëpunës civilë, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.
- Pozicionet e punës duhet të shpallen të lira, për t’u plotësuar më tej në përputhje me ligjin nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në koherencë me strukturën aktuale të Bashkisë Shijak.

3.Të kërkojë nga njësia përgjegjëse pranë Bashkisë Shijak, që të revokojë aktin nr. 402/1 prot., datë 05.05.2014, të nxjerrë nga njësia përgjegjëse e Komunës Xhafzotaj, “Akti i deklarimit të statusit të punësimit”, për punonjësen \*\*\*\*\* , si nëpunës civil në pozicionin e punës “arkëtare-magaziniere”, si akt i dalë në kundërshtim me ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore që kanë dalë në zbatim të tij, pasi në këtë rast, pozicioni i punës nuk është pjesë e shërbimit civil.

4.Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat **30** ditë nga marrja dijani për këtë vendim. Njësia përgjegjëse, duhet të zbatojë këtë vendim duke u bazuar në rekomandimet e materializuara në përmbajtjen e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes.

Me kalimin e afatit procedural të lënë për zbatimin e rekomandimeve në vendimin e mësipërm, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, bazuar në nenin 14, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në ligjin nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” dhe në Rregulloren “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit

Civil, vendosi kryerjen e mbikëqyrjes në vazhdim, për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në Vendimin nr.10, datë 26.01.2016.

Me Vendimin nr.65, datë 31.05.2016, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, u ngrit grupi i punës, i cili u paraqit në subjektin, Bashkia Shijak në datën 02.06.2016 dhe i kërkoi personit përgjegjës, nëpunëses \*\*\*\*\*\*, dosjet e personelit dhe dokumentacionin shkresor të dalë në zbatim të rekomandimeve të Komisionerit.

Në përfundim të verifikimit, rezultoi se :

- Në zbatim të pikës 2 të pjesës urdhëruese të vendimit nr.10, datë 26.01.2016, të Komisionerit, për punonjësit që nuk plotësonin kriteret për të qenë nëpunës civilë për shkak të mungesës së nivelit arsimor që kërkojnë këto pozicione, janë marrë masat si më poshtë:

1.Me shkresën nr. 383 prot., datë 17.02.2016, *”Njoftim për përfundimin e marrëdhënies së punës”*, titullari i institucionit, në mbështetje të ligjit nr.152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, si dhe rekomandimit të pikës 2 të Vendimit nr.10, datë 26.01.2016 të Komisionerit, ka vendosur përfundimin e marrëdhënies së punës për punonjësen Nimete Shkodra, me detyrë *”Specialiste në Sektorin e Taksave dhe Tarifave Vendore”*, për shkak se nuk plotësonte kërkesat e posaçme të nivelit arsimor të kërkuara nga ligji për shërbimin civil për këtë pozicion pune.

2.Me shkresën nr.1859/1 prot., datë 24.12.2015, *”Njoftim për përfundimin e marrëdhënies së punës”*, titullari i institucionit, bazuar në Kodin e Punës të Republikës së Shqipërisë dhe kërkesën e punonjësës për dorëheqje nga detyra, ka vendosur përfundimin e marrëdhënies së punës dhe ndërprerjen e marrëdhënieve financiare në datë 24.12.2015, për punonjësen \*\*\*\*\*\*, *”Specialiste në Sektorin e Infrastrukturës dhe Shërbimeve Publike”*, përpara daljes së vendimit të Komisionerit. Në këtë rast, kemi të bëjmë me një referim të gabuar të bazës ligjore për ndërprerjen e marrëdhënies së punësimit, për shkak se pozicioni i punës në të cilin ishte punësuar punonjësja \*\*\*\*\*\*, bën pjesë në shërbimin civil. Për këtë arsye, ndërprerja e marrëdhënies së punësimit duhej bërë mbi bazën e ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, për shkak të mospërmbushjes së kriterit të posaçëm të nivelit arsimor që kërkon ky pozicion pune, gjë e cila duhet të kihet parasysh në të ardhmen nga institucioni.

3.Titullari i institucionit, në mbështetje të ligjit nr. 115/2014, *“Për ndarjen administrativo-territoriale të njërive të qeverisjes vendore”*, të Ligjit nr. 7961, datë 12.07.2005, *“Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”*, i ndryshuar dhe VKM nr.510, datë 10.06.2015, *“Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrative-territorial”*, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 6, datë 21.08.2015, *“Për miratimin e numrit të përgjithshëm të punonjësve të Bashkisë”* dhe Urdhrit nr. 11, datë 25.08.2015, të Kryetarit të Bashkisë, *“Për miratimin e strukturës*

organizative të Bashkisë”, ka vendosur përfundimin e marrëdhënies së punës dhe ndërprerjen e marrëdhënieve financiare për shkak të ristrukturimit për punonjësit e mëposhtëm:

- a.Me shkresën nr.930/12 prot., datë 31.08.2015, “Njoftim për ndërprerjen e marrëdhënies së punës”, për punonjësen \*\*\*\*\*, me detyrë “Specialiste në Sektorin e Taksave dhe Tarifave Vendore”;
- b.Me shkresën nr. 930/13 prot., dt.31.08.2015, “Njoftim për ndërprerjen e marrëdhënies së punës”, për punonjësen \*\*\*\*\*, me detyrë “Specialiste në Sektorin Urbanistik”;
- c.Me shkresën nr.930/7 prot., dt.31.08.2015, “Njoftim për ndërprerjen e marrëdhënies së punës”, për punonjësin \*\*\*\*\*, me detyrë “Specialist Topograf”;
- d.Me shkresën nr.930/3 prot., dt.31.08.2015, “Njoftim për ndërprerjen e marrëdhënies së punës”, për punonjësin \*\*\*\*\*, me detyrë “Inspektor Ndërtimi”;
- e.Me shkresën nr.930/9 prot., dt.31.08.2015, “Njoftim për ndërprerjen e marrëdhënies së punës”, për punonjësin \*\*\*\*\*, me detyrë “Inspektor Ndërtimi”;
- f.Me shkresën nr.942 prot., dt.1.09.2015, “Njoftim për ndërprerjen e marrëdhënies së punës”, për punonjësin \*\*\*\*\*, me detyrë “Përgjegjës Sektori i Shërbimeve”;
- g.Me shkresën nr.1171 prot., dt.23.09.2015, “Njoftim për ndërprerjen e marrëdhënies së punës”, për punonjësin \*\*\*\*\*, me detyrë “Inspektor i Tatim-Taksave”;
- h.Me shkresën nr.1167 prot., dt.23.09.2015, “Njoftim për ndërprerjen e marrëdhënies së punës”, për punonjësin \*\*\*\*\*, me detyrë “Inspektor Pyje dhe Kullota”.

Nga komunikimi me grupin e mbikëqyrjes, këqyrja e akteve të administruara prej tij dhe dakordësia e shprehur nga institucioni (referuar shkresës nr. 10 prot., datë 06.01.2016, të Bashkisë Shijak) pas njohjes me projektraportin e përgatitur nga grupi i mbikëqyrjes rezultoi se këto akte administrative nuk i janë vënë në dispozicion këtij të fundit. Komisioneri ka rënë në dijeni të këtyre akteve në momentin e verifikimit të zbatimit të Vendimit nr.10, datë 26.01.2016.

Sa më sipër, rezultoi se njësia përgjegjëse ka gabuar kur ka ndërprerë marrëdhënien e punës së këtyre punonjësve për shkak të ristrukturimit, pasi referuar shkronjës “e” të nenit 21 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, një kandidat për nëpunës civil duhet të plotësojë kërkesat e posaçme për nivelin e arsimit, që në këtë rast është arsim i lartë. Në kushtet kur punonjësit nuk e plotësojnë këtë kriter, njësia e burimeve njerëzore duhet të vendoste përfundimin e marrëdhënies së punësimit për këta punonjës në përputhje me pikën 6 të Vendimit nr. 116, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”.

Në këto kushte, aktet e mësipërme administrative kanë dalë në kundërshtim me shkronjën “d” të nenit 109 të ligjit nr.44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”. Për këtë arsye, referuar nenit 113 të këtij Kodi, organi

publik duhet të bëjë shfuqizimin e tyre, duke ndryshuar motivacionin e largimit nga detyra dhe aktet e shfuqizimit t'i bëjë pjesë të dosjes së personelit për këta punonjës.

- 4.Me shkresën nr.384 prot., datë 17.02.2016, "Njoftim për ndërprerjen e marrëdhënies së punës", titullari i institucionit, në mbështetje të ligjit nr.152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, si dhe rekomandimit të pikës 2 të Vendimit nr.10, datë 26.01.2016 të Komisionerit, ka vendosur përfundimin e marrëdhënies së punës për punonjësin Ruzhdi Domi, me detyrë "Specialist i Planifikimit Kadastral", për shkak se ai nuk plotësonte kriterin e posaçëm të nivelit arsimor që kërkon ky pozicion pune.
- 5.Me shkresën nr.385 prot., datë 17.02.2016, "Njoftim për ndërprerjen e marrëdhënies së punës", titullari i institucionit, në mbështetje të ligjit nr.152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, si dhe rekomandimit të pikës 2 të Vendimit nr.10, datë 26.01.2016 të Komisionerit, ka vendosur përfundimin e marrëdhënies së punës për punonjësin \*\*\*\*\* , me detyrë "Specialist Veteriner", për shkak se ai nuk plotësonte kriterin e posaçëm të nivelit arsimor që kërkon ky pozicion pune.
6. Me Urdhrin e Brendshëm nr.204 Prot., datë 02.02.2015, dalë në bazë e zbatim të ligjit nr.8652, datë 31.07.2000 "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Qeverisjes Vendore", i ndryshuar, titullari i institucionit ka liruar nga detyra "Specialist i Shërbimeve", punonjësin \*\*\*\*\* dhe e ka emëruar "Nën Kryetar" në Njësinë Administrative Maminas, pozicion që nuk përfshihet në fushën e veprimit të ligjit për shërbimin civil.
- 7.Me Urdhërin nr.3011 Prot., datë 31.12.2014, "Njoftim për ndërprerjen e marrëdhënies së punës", titullari i institucionit, ka vendosur përfundimin e marrëdhënies së punës për punonjësin \*\*\*\*\* , me detyrë "Specialist i shërbimeve" në ish Komunën Maminas, për shkak të dorëheqjes së tij.
- 8.Në lidhje me punonjësin \*\*\*\*\* , me detyrë "Arkivist" në ish Komunën Gjepalaj, u pretendua nga përfaqësuesi i Njësisë Përgjegjëse të Bashkisë Shijak, se i është ndërprerë marrëdhënia e punësimit përpara miratimit të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.6, datë 21.08.2015, "Për miratimin e numrit të përgjithshëm të punonjësve të Bashkisë Shijak" dhe Urdhërit nr.11, datë 25.06.2015, të Kryetarit të Bashkisë, "Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë". Për të provuar këtë pretendim grupi i punës administroi listëprezencat e muajit Maj 2016 të Bashkisë Shijak dhe Njësisë Administrative Xhafzotaj, Maminas, Gjepalaj. Nga këqyrja e listëprezencave rezultoi se nuk figuronte punonjësi Serhet Kokomani, çka presupozon ndërprerjen e marrëdhënies së punës për këtë punonjës.

Në lidhje me zbatimin e rekomandimit të paragrafit të dytë të pikës 2 të Vendimit nr.10, datë 26.01.2016, për shpalljen të lira të pozicioneve të mësipërme, nga ana e Njësisë Përgjegjëse të Bashkisë Shijak, kanë dalë në respektim të nenit 22 dhe 25 të ligjit 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, shpalljet për lëvizje paralele dhe për pranimin në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive "Specialist".

- Në lidhje me aktin e deklarimit të statusit të punësimit për punonjësen \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës “arkëtare-magaziniere”, të dalë në kundërshtim me ligjin, njësia përgjegjëse, në përputhje me rekomandimin e Komisionerit në pikën 3 të vendimit, ka bërë revokimin e tij me aktin administrativ nr.940 Prot., datë 01.09.2015. Akti i revokimit, edhe pse daton më herët se fillimi i mbikëqyrjes në institucion, nuk ka qenë pjesë e dokumentacionit që i është vënë në dispozicion grupit të mbikëqyrjes.

Për sa u parashtrua më sipër, pas përfundimit të afatit për zbatimin e detyrave të lëna në Vendimit nr.10, datë 26.01.2016 “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në Bashkinë Shijak”, të Komisionerit, rezulton se nga ana e njësisë së burimeve njerëzore të institucionit të Bashkisë Shijak nuk janë zbatuar të gjitha rekomandimet e lëna në vendimin paralajmërues.

#### **Për këto arsye:**

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; nenin 90, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” dhe 34 të Rregullores, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr.17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

#### **VENDOSA:**

- 1.Përfundimin e procesit të verifikimit për zbatimin e Vendimit nr.10, datë 26.01.2016, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil”, institucionin e Bashkisë Shijak.
- 2.Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e njësisë së burimeve njerëzore të institucionit të Bashkisë Shijak, duke zbatuar në përgjithësi rekomandimet e Vendimit nr.10, datë 26.01.2016 “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në Bashkinë Shijak”.
3. Përmbushja e detyrave të cilat janë evidentuar si të pazbatuara apo të zbatuara gabim nga ana e Bashkisë Shijak në përmbajtjen e këtij vendimi, do të jenë objekt i verifikimit të mëtejshëm nga ana e Komisionerit.
- 4.Për këtë vendim të njoftohet institucioni, Bashkia Shijak dhe Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në Kuvendin e Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

#### **KOMISIONERI**

**Pranvera STRAKOSHA**